

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **634-23-6808-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE , DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Master Services SH.P.K.
NUI	811921792
Adresa	Rruga Faik Konica L-2
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	046/430-000
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Florent Shala
Adresa elektronike	masterservices.shpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	11.08.2023

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE , DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 1 MIREMBAJTJE HIXHENIKE TE OBJEKTEVE||**SHERBIME TE MIREMBAJTJES HIXHENIKE TE OBJEKTEVE , DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE LOT 2 - SIGURIM FIZIK TE OBJEKTEVE**

Njoftimi per kontrate, 04.07.2023

Hapja e ofertave, 19.07.2023

Njoftim mbi vendimin e AK, 04.08.2023

Kerkesa per rishqyrtim, 06.08.2023

Vendim i AK per kerkesen per rishqyrtim, 08.08.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 06.08.2023 kemi dorëzuar kërkesë për rishqyrtim konform Nenit 108/A brenda afatit të lejuar ligjor përmes platformës së e-Prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat ligjore të LPP-se të cilat konsiderojmë se janë shkelur në këto aktivitete të prokurimit:

Neni 1 Qëllimi,
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve,
Neni 60 Kriteret për Dhënie të Kontrates,
Neni 61 Tenderet Jo-normalisht të Ulet,
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Si pale me interes sipas par.1.26 të Nenit 4 të LPP-se dhe pale e pakenaqr me njoftimin e datës 04.08.2023 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues "Kuvendi Komunal i Klines" në lidhje me aktivitetin e prokurimit "SHERBIME TË MIREMBAJTJES HIXHENIKE TË OBJEKTEVE, DHE SIGURIM FIZIK I OBJEKTEVE - LOT1" me numër prokurimi 634-23-6808-2-1-1 dhe përgjigjen e AK-se ndaj kërkesës sone për rishqyrtim të datës 08.08.2023 në afat në lejuar ligjor konform Nenit 109 të LPP-se paraqesim këtë:

ANKESE

Në mënyrë të kundershtueshme e rekomandojmë operatorin ekonomik të cilin shihet se e ka favorizuar duke iu shmangur komunikimeve zyrtare vetëm e vetëm që të arrijë tek kompania e cila dyshohet se ka lidhje të ngushtë me zyrtarët e prokurimit, dhe kështu demton procedurën, demton buxhetin si dhe neve si pale të interesit në këto aktivitete të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues në njoftimin e kontratës dhe dosje të tenderit ka kërkuar shërbime për Lot 1 për mirëmbajtjen hixhenike të objekteve, e që kriteri kryesor sipas kërkesave të vendosura në dosje dhe njoftim ka qenë Neni 60 par. 1 që oferta e përgjigjshme me

cmimin me te ulet do te shperblehet me kontrate. Kompania jone qellimisht ne menyre tendencioze eliminohet ne menyren me te keqe te veprimit te kunderligjshem nga zyra e prokurimit, ashtu siq e potencuam per te arritur deri tek caku i tyre favorizimi i kompanise tani me te rekomanduar per kontrate.

Ne njoftimin mbi vendimin e AK, te dates 04.08.2023 te ngritur ne platformen e E-prokurimit tek letra standarde per kompanine tone thuhet se arsyeja e eliminimit ka qene qe "kompania jone kinse" nuk iu eshte pergjigjur letres standarde per sqarimin e tenderit lidhur me sqarimin e ofertes nen pragun e lejuar?

Autoriteti Kontraktues letren standarde per sqarimin e tenderit nuk na ka derguar, ketu eshte dashur te verteton se nje gje e till ka kaluar nepermjet kanalit zyrtar (obligativ) platformes se e-Prokurimit, gje qe kompania jone nuk ka pranuar asnje dokument nga ana e AK-se per sqarimin e tenderit.

Neni 38.1 dhe 38.8 i Rregullores Nr.001/2022 per Prokurimin Publik thote:

38.1 - Per te lehtesuar ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve, AK mund te kerktoj nga secili tenderues individualisht per sqarim te tenderit te tij/saj. KRPP ka aprovuar nje formular standard B47 per sqarime per te perdorur nga AK "Kerkese per sqarim te tenderit". Kerkesa per sqarim dhe pergjigja duhet te behet permes platformes elektronike.

38.8 - "Kerkesen per sqarim te tenderit" AK duhet t'a dergoje nepermjet sistemit te prokurimit elektronik. OE pergjigjen ne "Kerkesen per sqarim te tenderit" duhet t'a dergoje nepermjet sistemit te prokurimit elektronik.

Pra qe te dya dispozita ligjore te Rregullores per prokurimin publik qartazi tregojne se si kerkesa ashtu edhe pergjigja duhet te behen vetem permes platformes se E-prokurimit, e qe kompania jone nuk ka pranuar ne llogarine e vet ne platformen e E-prokurimit asnje leter, dokument apo kerkese nga Autoriteti Kontraktues, me c'rast eliminimi yne eshte i padrejte dhe

tendencioz.

Ne i jemi drejtuar me daten 08.08.2023 Departamentit te IT (KRPP) ku kemi kerkuar nga ta qe te shiqojne ne platformen e E-prokurimit nese ekziston ndonje dokument i leshuar nga Autoriteti Kontraktues ne llogarine tone.

Me daten 09.08.2023 kemi pranuar pergjigjen zyrtare ku Departamenti i IT (KRPP) na tregon se nuk ka asnje evidence nese AK ka derguar ndonje dokument ne llogarine tone.

Sa i perket ceshtjes se "pragut te lejuar", ky term askund nuk ka qene pjese apo kriter i matshem ne dosjen e tenderit dhe nuk ka qene kerkese obligative si term, dhe nuk e kuptojme per cfare pragu Autoriteti Kontraktues ka folur ne letren standarde per tenderuesin e eliminuar te publikuar ne njoftimin mbi vendimin e AK-se, ne lidhje me

pagat e punetoreve.

Se pari kompania jone ka te vendosur "nje deklarate" se do te rrespektoj ne perpikmeri kerketat e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pagat e punetoreve dhe ceshtjeve te tjera te lidhura me Ligjin e Punes, dhe se termi i perdorur ne letren standarde pragu i lejuar ashtu siq e potencuam askund ska qene kriter i matshem apo obligativ qe te mund te perdoret tani si arsye e eleminimit?

Neni 40.12 i Rregullores Nr.001/2022 per Prokurimin Publik thote:

Tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose perjashtohet nga procedura e prokurimit ne baze te ndonje kerkese apo kriteri qe nuk eshte specifikuar ne njoftimin e kontrates / dosjen e tenderit.

Ne pos deklarates per paga kemi vendosur edhe deklaraten per specifikimet teknike se do te i zbatojme ne perpikmeri gjate ezekutimit te kontrates, dhe se AK si mund ta bene vleresimin akoma ne si kompani pa filluar implementimin e kontrates, pra ne vend se te vazhdon me vleresimin e ofertave konform dispozitave ligjore, te njejtit vazhdojn me hamendje te kota, duke mos e menduar se te njejtit na shkaktojne deme.

Neni 40.13 i Rregullores Nr.001/2022 per Prokurimin Publik thote:

AK do t'i vleresoje dhe krahasoj tenderet e pergjegjshem sipas kriterëve per dhenien e kontrates te percaktuara ne njoftimin e kontrates / dosjen e tenderit. Po qe se Autoriteti Kontraktues ka pasur dilema te tjera edhe pse nuk eshte dashur te kete

perderisa ne kemi garantuar dhe kemi dhene nje deklarate se do te rrespektojme pagen e caktuar ne dosjen e tenderit eshte dashur qe te bene vleresimin konform Nenit 59.4 te LPP-se ku thote:

Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerketat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit. Pavaresisht nga e meparshmja, autoriteti kontraktues mund te konsideroje nje tender si te pergjegjshem nese: (i) permban vetem gabime ose

paqartesi te cilat mund te korrigojohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekun e tenderit ne fjale, ose (ii) permban vetem devijime te vogla qe nuk mund te shkaktojne ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kerketat e tjera te parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit; me kusht qe, çfaredo devijimi i till te kuantifikohet, aq sa eshte e mundshme, dhe te merret parasysh gjate vleresimit dhe krahasimit te tendereve.

Meqenese qellimi kryesor i secilit aktivitet te prokurimit sipas ligjeve ne fuqi eshte qe te gjitha procedurat qe zhvillohen duhet te perdorin fondet publike ne menyre sa me ekonomike, ateher Autoriteti Kontraktues eshte dashur qe te zbatoj Nenin 1 te LPP-se, te shperblen me kontrate oferten tone e cila eshte me lire se oferta e rekomanduar per kontrate ne vlere prej 6,249.66 euro e jo te demtoj buxhetin e Republikes se Kosoves per

nje kontrate te thjesht e cila eshte sherbim qe do te kryhet permes te njejteve punetor aktual e te cilet do te marrin te njejtat paga te caktuara.

Autoriteti Kontraktues duhet te mbroj buxhetin e Republikes se Kosoves dhe jo ta demtoj, dhe e paralajmërojme si institucion se nese do te kete leshime te tilla per kete aktivitet te prokurimit ne do ti ndjekim te gjitha instancat tjera si dhe do te drejtohem organeve te ndjekjes duke mbrojtur te drejtat tona qe na takojne me ligj.

Autoriteti Kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit nuk e ka pasur ne konsiderate Nenin 7 te LPP-se (Barazia ne trajtim/Jo-diskriminimi) ku qellimi i ketij neni eshte qe Autoriteti Kontraktues duhet ti trajtoj te barabarte operatorët ekonomik dhe jo-diskriminuese dhe te veproj ne menyre transparente.

Poashtu Autoriteti Kontraktues nuk e ka rrespektuar ashtu siq e kemi cekur edhe me larte kriterin kryesor per dhenien e kontrates e qe nuk eshte rrespektuar as Neni 59.4 i LPP-se ku vleresimi, krahasimi dhe ekzaminimi i ofertave nuk eshte konform kerkesave.

Andaj bazuar ne te gjitha argumentet dhe provat e lartecekura si dhe dispozitat ligjore te cekura kerkojme nga Autoriteti Kontraktues qe te nxjerr kete:

VENDIM

1. **Aprovohet e bazuar**, ankesa per aktivitetin e prokurimit ne fjale,
2. **Anulohet** njoftimi mbi vendimin e AK, e dates 04.08.2023, dhe lenda te kthehet ne Rivleresim.

Ne te kunderten ne afatin e lejuar ligjor ne do te paraqesim edhe ankese prane Organit Shqyrtues te Prokurimit me provat dhe argumentet qe posedojme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si Operator Ekonomik kemi shpenzime te konsiderueshme ne pergatitjen e dokumentacionit, ofertave, dhe pjeseve te tjera te cilat nderlidhen me kete aktivitet te prokurimit, shpenzimet e avokatise ne pergatitjen e ankesave dhe shpenzimet e sigurimit te tenderit.

Demi reflekton edhe ne demin material dhe jo-material i cili shtrihet edhe ne raport me LMD-ne Neni 136 dhe Neni 137 duke mos u kufizuar edhe ne demtimin e imazhit dhe pasojave te tjera te cilat nuk mund jene te konkretizuara ne kete faze.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*